

VENDIM
Nr. 1128, datë 30.12.2020

PËR ZBATIMIN NGA REPUBLIKA E SHQIPËRISË TË VENDIMEVE TË
KËSHILLIT TË BASHKIMIT EVROPIAN, PËR VENDOSJEN, NDRYSHIMIN DHE
SHFUQIZIMIN E MASAVE SHTRËNGUESE NDËRKOMBËTARE, TË
NDRYSHUARA

Në mbështetje të pikës 2, të nenit 100, të Kushtetutës, të neneve 3, pika 3, shkronja “c”, dhe 6, pikat 2 e 5, të ligjit nr. 72/2019, “Për masat shtrënguese ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e Kryeministrit dhe ministër për Evropën dhe Punët e Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Zbatimin nga Republika e Shqipërisë të vendimeve të Këshillit të Bashkimit Evropian, për vendosjen, ndryshimin dhe shfuqizimin e masave shtrënguese ndërkombëtare, sipas anekseve që i bashkëlidhen këtij vendimi, përkatësisht:

1. Vendimin e Këshillit të Bashkimit Evropian (CFSP) 2018/1544, “Për vendosjen të masave kufizuese kundër përhapjes dhe përdorimit të armëve kimike”, të ndryshuar, sipas aneksit 1.

2. Vendimin e Këshillit të Bashkimit Evropian (CFSP) 2010/638, “Për vendosjen e masave kufizuese kundër Republikës së Guinesë”, të ndryshuar, sipas aneksit 2.

3. Vendimin e Këshillit të Bashkimit Evropian (CFSP) 2016/1693, “Për vendosjen e masave kufizuese kundër ISIL dhe Al-Qaeda dhe individëve, grupeve, ndërmarrjeve dhe entiteteve të lidhura me to”, të ndryshuar, sipas aneksit 3.

4. Vendimin e Këshillit të Bashkimit Evropian (CFSP) 2015/1333, “Për vendosjen dhe heqjen e masave kufizuese, në kuadër të situatës në Libi”, të ndryshuar, sipas aneksit 4.

5. Vendimin e Këshillit të Bashkimit Evropian (CFSP) 2019/1720, “Për vendosjen e masave kufizuese në kuadër të situatës në Nikaragua”, të ndryshuar, sipas aneksit 5.

6. Vendimin e Këshillit të Bashkimit Evropian (CFSP) 2019/797, “Për vendosjen e masave kufizuese kundër sulmeve kibernetike që kërcënojnë BE-në”, të ndryshuar, sipas aneksit 6.

7. Vendimin e Këshillit të Bashkimit Evropian (CFSP) 2014/145, “Për vendosjen e masave shtrënguese, për sa u përket veprimeve që cenojnë integritetin territorial, sovranitetin dhe pavarësinë e Ukrainës”, të ndryshuar, sipas aneksit 7.

8. Vendimin e Këshillit të Bashkimit Evropian (CFSP) 2013/255, “Për vendosjen e masave kufizuese kundër Sirisë”, të ndryshuar sipas aneksit 8.

9. Vendimin e Këshillit të Bashkimit Evropian (CFSP) 2010/413, “Për vendosjen e masave kufizuese kundër Iranit”, të ndryshuar, sipas aneksit 9.

10. Vendimin e Këshillit të Bashkimit Evropian (CFSP) 2017/2074, “Për vendosjen e masave kufizuese në kuadër të situatës në Venezuelë”, të ndryshuar, sipas aneksit 10.

11. Vendimin e Këshillit të Bashkimit Evropian (CFSP) 2010/573, “Për vendosjen e masave kufizuese kundër udhëheqjes së rajonit të Transnistrias të Republikës së Moldavisë”, të ndryshuar, sipas aneksit 11.

12. Vendimin e Këshillit të Bashkimit Evropian (CFSP) 2012/642, “Për vendosjen e masave kufizuese kundër Bjellorusisë”, të ndryshuar, sipas aneksit 12.

II. Ngarkohen institucionet e parashikuara në pikën 1, të nenit 11, të ligjit nr. 72/2019, “Për masat shtrënguese ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama